

**V E N D I M**  
**Nr. 438, datë 14.8.1995**

**PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE TË TRANSFORMUARA  
NË SHOQËRI TREGTARE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 553, datë 16.10.1995; me vendimin e Gjykatës Kushtetuese  
nr. 26, datë 24.4.2001)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimëtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Të fillojë shitja e aksioneve të shoqërive tregtare të transformuara nga ndërmarrjet shtetërore në bazë të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”.

2. Kërkesë në këtë vendim do të kuptohet sasia e letrave me vlerë që investohen për të blerë aksione në shoqëritë tregtare që privatizohen.

Ofertë në këtë vendim do të kuptohet kapitali themeltar i shoqërive tregtare që shpallen për privatizim.

3. Forma e privatizimit të aksioneve të shoqërive tregtare është ankandi. Mekanizimi i zhvillimit të ankandit të aksioneve është ai pa çmim të llogaritur, sipas të cilit oferta dhe kërkesa për aksione të shoqërisë që do të privatizohet shkojnë gjithnjë paralelisht.

Mënyra e shpërndarjes së kapitalit fillestar ose aksioneve do të jetë ai përpjesëtimor që do të varet nga rezultatet përfundimëtare të raportit kërkesë-ofertë si pasojë e arritjes së vlerës së tregut në një periudhë të caktuar kohe.

I. Kur kërkesa e tejkalon ofertën, aksionet shpërndahen në përpjesëtim të drejtë me sasinë e letrave me vlerë (bonove të privatizimit, lekëve të privatizimit) të ofruara nga kërkuesit.

II. Kur kërkesa është jo më e madhe se oferta, ankandi përfundon dhe gjithë aksionet e shoqërisë shpërndahen në mënyrë përpjesëtimore me sasinë e letrave me vlerë të ofruara nga kërkuesit.

4. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim me subjektet e tjera kërkuese, në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” kanë të drejtë të marrin aksione ose pjesë të kapitalit të shoqërisë që privatizohet. Ish-pronari i truallit për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve. Ai zotëron një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë pavarësisht nga rezultatet e ankandit. Brenda afatit të mbledhjes së kërkesave ish-pronari i truallit paraqet një kërkesë me shkrim në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit se kërkon që të zotërojë aksione në kapitalin e shoqërisë që privatizohet në përpjesëtim me vlerën e truallit që atij i është kthyer.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, për shoqëritë që do të privatizohen, brenda periudhës së publikimit kërkon nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve një vërtetim me shkrim mbi pronësinë e truallit.

Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pasi merr të dhënat nëpërmjet komisioneve në bashki e rrethe njoftonë pronësinë mbi truallin brenda një afati jo më shumë se 2 muaj nga fillimi i publikimit.

Kur ish-pronari i truallit nuk paraqet kërkesën e tij brenda afatit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit bën privatizimin e kësaj pjese sipas metodës së ankandit.

*5. Punonjësit e shoqërisë që privatizohet, si dhe ish-punonjësit e tyre që kanë përfituar nga legjislacioni për përkrahjen sociale, ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore nga zbatimi i reformës ekonomike, kanë të drejtë që sipas dëshirës së tyre të marrin pjesë në ankand duke kërkuar aksione të shoqërisë ku ato kanë punuar ose punojnë, për të gjithë shumën e bonove të privatizimit përfituar sipas dekretit “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” me ndryshimet përkatëse.*

Kjo e drejtë u njohet atyre në rast se do të kërkojnë aksione vetëm në shoqërinë ku aktualisht punojnë.

6. Procedura e privatizimit të shoqërive tregtare ka elemente kohore:

a) Valë privatizimi, me të cilën kuptohet periudha gjatë së cilës përfundohet shitja e disa grupeve shoqërisht tregtare të ofruara për shitje.

b) Raund privatizimi, me të cilën kuptohet periudha gjatë së cilës hidhet për privatizim një grup i caktuar shoqërisht, brenda një vale do të ketë disa raunde privatizimi. Raundi i privatizimit zgjat jo më shumë se 45 ditë.

7. Me depozitimin e dokumentacionit të grupit të shoqërive tregtare që do të privatizohen nga ana e Drejtorisë së Shoqërive Publike në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, kjo e fundit bën publikimin për një periudhë kohe jo më pak se 15 ditë.

8. Pas përfundimit të afatit të publikimit për grupin e parë të shoqërive fillon vala e njëkohësisht raundi i parë i privatizimit.

Gjatë periudhës së zgjatjes së raundit kryhet procedura e regjistrimit të personave fizikë dhe juridikë, duke porositur aksione të shoqërive në shkëmbim të letrave me vlerë.

Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të porositin aksione për çdo shoqëri tregtare të shpallur për shitje, në mënyrë të njëkohshme në të gjithë qendrat e ankandëve të degëve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe, pavarësisht nga vendndodhja e shoqërisë tregtare.

Përfundimi i periudhës së regjistrimit (ose porosisë për blerje aksionesh) shënon dhe përfundimin e privatizimit të kapitalit (ose pjesëve të tij) të shoqërisë sipas shpalljes.

9. Agjencia Kombëtare e Privatizimit me marrjen e dokumentacionit të privatizimit të shoqërive, fillon publikimin.

Publikimi bëhet në tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën 6 herë, në gazetën lokale të paktën dy herë, si dhe në rrethin ku ndodhet shoqëria vendosen afishe, ndër të cilat detyrimisht në zyrën e regjistrimit të kërkesave, në qendrën e qytetit dhe në qendrën e shoqërisë që do të privatizohet apo në të gjitha pjesët e saj.

10. Për shpalljen përfundimtare të rezultateve Agjencia Kombëtare e Privatizimit vepron vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin përkatës nga Qendra e Përpunimit të Informacionit Financiar (QPIF).

QPIF, brenda 14 ditëve nga data e përfundimit të mbledhjes së kërkesave, për çdo rast të përcaktuar në paragrafët I dhe II të pikës 3 të këtij vendimi, jep rezultatin përfundimtar tek Agjencia Kombëtare e Privatizimit mbi pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë të secilit subjekt kërkuar.

Bazuar në këto rezultate, Agjencia Kombëtare e Privatizimit i dërgon listën e aksionerëve shoqërisë që u privatizua, e cila bën komunikimin e kësaj liste tek aksionerët.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi më datën 1 shtator 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**